



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:054034  
Datë: 09.10.2024  
Numri i dokumentit: 06272757

Pml.nr.615/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Supreme e Kosovës – në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale ndaj të pandehurve E. S., M. Gj. dhe A. M., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), falsifikimi i parasë, nga neni 296 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe veprën penale shpëlarja e parave nga neni 302 lidhur me nenin 31 të KPRK lidhur me nenin 56 par. 1 nën par. 1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve, të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PPPS.nr.12/2024 të datës 11.09.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.S.nr.208/2024 të datës 28.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 09.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I Me miratimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve E. S., M. Gj. dhe A. M., anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.S.nr. 208/2024 të datës 20.09.2024 dhe çështja i kthehet kësaj gjykate në rivendosje.

II Të pandehurit duhet të qëndrojnë në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me aktvendimin PPPS.nr.12/2024 të datës 11.09.2024, të pandehurve A. K., E. S., M. Gj. dhe A. M., të gjithë nga Shqipëria, për shkak të veprës penale blerja, pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 333 par. 1 lidhur me nenin 31 KPRK, falsifikimi i parasë, nga neni 296 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe veprën penale shpëlarja e parave, nga neni 302 lidhur me nenin 31 të KPRK lidhur me nenin 56 par. 1 nën par. 1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, ua ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, e cila masë do t’iu zgjasë nga data 11.09.2024 deri më datën 11.11.2024. Masa e paraburgimit iu është vazhduar në bazë të nenit 184 par. 1. nën par. 1.1, dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.I.S.nr.208/2024 e datës 20.09.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve E. S., M. Gj. dhe A. M. dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurës E. S. av.Arbër Shala, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 188, neni 384 par. 2 nën par. 2.1 lidhur me nenin 3 dhe nenin 184 par. 2 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3, nenit 187 par. 2 nën par. 2.2 të KPP dhe shkeljeve të të drejtave të siguruara me KPP të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe KEDNJ (neni 440 KPP), me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara dhe të pandehurës t’i ndërpritet masa e paraburgimit dhe të urdhërohet lirimi i sajë i menjëhershëm;

- mbrojtësi i të pandehurit M. Gj. av.Betim Shala, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 188, neni 384 par. 2 nën par. 2.1 lidhur me nenin 3 dhe nenin 184 par. 2 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3, nenit 187 par. 2 nën par. 2.2 dhe nenin 440 të KPP, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara dhe të pandehurit t’i ndërpritet masa e paraburgimit apo kjo masë t’i zëvendësohet me masën e dorëzimit në shumë prej 15000€ apo me masën e arrestit shtëpiak dhe të urdhërohet lirimi i tij i menjëhershëm, dhe

- mbrojtësi i të pandehurit A. M. av. Fanol R. Krasniqi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 (treziku i arratisjes) të KPP, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara dhe të pandehurit t’i ndërpritet masa e paraburgimit apo masa e paraburgimit t’i zëvendësohet me masën e dorëzimit në shumë prej 25.000€.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.260/2024 të datës 04.10.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të pandehurve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të bazuara.

Në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësit e të pandehurve, ndër të tjerat, theksojnë se aktvendimet e kundërshtuara janë në kundërshtim me nenin 188 par. 1 të KPP, ngase kërkesa e Prokurorisë është ushtruar një ditë (me datë 10.09.2024) para datës së skadimit të vazhdimit të masës së paraburgimit (11.09.2024), ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës nuk është përgjigjur lidhur me këtë pretendim, lidhur me afatshmërinë apo pasafatshmërinë e kërkesës së prokurorisë.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësve të të pandehurve se aktvendimi i gjykatës së Apelit të Kosovës është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që, siç del nga shkresat e lëndës dhe nga vendimi i ankimuar, mbrojtësit kanë paraqitur si pretendim ankimor se kërkesa për vazhdimin e masës së paraburgimit është dorëzuar me datën 10.09.2024 në kundërshtim me dispozitën e nenit 188 të KPP, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës, në vendimin e saj ka potencuar shkeljen me rastin e elaborimit të ankesave të mbrojtësve, mirëpo në arsyetim nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me këtë çështje, duke e anashkaluar këtë pretendim thelbësor.

Në këtë mënyrë, duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që t'i aprovon si të bazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërsa të anulon aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që gjykata në fjalë nuk ka vlerësuar dhe arsyetuar pretendimet e lartcekura të mbrojtësve, duke u bazuar në nenin 404 par. 1 të KPP, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet kësaj gjykate në rivendosje.

Në rivendosje, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësoj të gjitha pretendimet nga ankesat e mbrojtësve të të pandehurve, dhe pastaj të merr vendim në këtë çështje, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete lidhur me pretendimet nga ankesat.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438 par. 1, nën-par. 1.2 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr. 615/2024 me datën 09.10.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale  
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka